VENDIM
Nr. 573, datë 23.8.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS HYSGJOKAJ, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Hysgjokaj, të qarkut të Fierit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Hysgjokaj, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.130, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Hysgjokaj".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Hysgjokaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Hysgjokaj Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
2-5; 15-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore	Në pronësi
19, 20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57-78	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
79	Infrastrukturë (troje, të lira)	Në përdorim
90,91,92,93,94,95,96,97,98,99	Infrastrukturë (troje, rrugë vendore)	Në pronësi

80-88	Shërbim funeral	Në pronësi
7-14	Mbrojtje civile	Në pronësi
100-123	Shërbim publik (furnizim me ujë)	Në pronësi
29,31,32,33,36,38	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
27,28,30	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim